



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600064/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim në lidhje me ndërtimin sa më parë dhe vënien në funksionim të plotë të Urave në fshatrat Broshkë (Papër) dhe Grykësh (Pajovë), të dëmtuar nga përmbytjet e shkaktuara në muajin Janar 2016 nga dalja e Lumit Shkumbin.*

Drejtuar : Z. Arben Kamami
Prefekt i Qarkut

ELBASAN

Z. Qazim Sejdini
Kryetar i Bashkisë

ELBASAN

Z. Saimir Hasalla
Kryetar i Bashkisë

PEQIN

Z. Shemsi Prençi
Drejtore i Përgjithshme i Emergjencave Civile
Ministria e Punëve të Brëndshme

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Nisur nga shqetësimet e banorëve të Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Peqin, të prezantuara në median vizive, mbi shkatërrimet e pësuar kryesisht në urën e Broshkës dhe urën e Grykëshit, por dhe në urën e Çengelaj, urën e vjetër të Peqinit dhe të By Pass-it të Peqinit, Avokati i Popullit z. Igli Totozani dhe grupi i ekspertëve të Institucionit, monitoruan nga afër situatën e krijuar për banorët e izoluar të këtyre zonave.

Në takimet e Avokatit të Popullit me banorë dhe përfaqësues të pushtetit vendor, si dhe të strukturave të emergjencave civile të qarkut Elbasan rezultoj se, zonat e prekura më së shumti nga përmbytjet për shkak të shirave të rrëmbyeshëm dhe daljes nga shtrati të Lumit Shkumbin, janë zonat e banuara përgjatë shtratit të këtij lumi. Kjo situatë është përkeqësuar së tepërmi për banorët e fshatrave Broshkë (Papër) dhe Grykësh (Pajovë), si pasojë e shkatërrimit total të urës të Broshkës dhe urës të Grykëshit, duke u bërë të pakalueshme për banorët dhe mjetet e transportit të fshatrave respektive.

Fshati Broshkë përbëhet nga 450 familje ose me rreth 1400 banorë. Ura e Broshkës (urë vetëm për këmbësorët) është e ndërtuar në vitin 1999-2000 me investimet e pushtetit vendor. Prej asaj kohe, përfaqësuesit e banorëve deklarojnë se, nuk është bërë asnjë investim për mirëmbajtjen e saj, me

përrjashtim të disa fondeve të pakta për zëvendësimin e dërrasave të kalbura në vite. Rruga tjetër që banorët dhe fëmijët mundet të komunikojnë nga fshati me rrugën nacionale, ndodhet në një distancë prej rreth 1 orë më larg.

Fshati Grykësh përbëhet nga një popullsi me rreth 3000 banorë. Ura e Grykëshit e ndërtuar në vitin 2008, falë një bashkëpunimi të Ministrisë të Mbrojtjes dhe ish-Komunës Pajovë (Peqin), ka dalë jashtë funksionit për shkak të daljes nga shtrati të lumit Shkumbin dhe zgjerimit të shtratit tej parametrave të parashikuar nga studimi teknik dhe gjeologjik në ndërtimin e bazamenteve të urës në të dyja anët e këtij lumi.

Këputja e urave, përveç se ka ndërprerë komunikimin e banorëve të fshatrave me zonat e tjera, ka sjellë për pasojë izolimin e popullatës, mungesën e shkëmbimit të aktivitetit ekonomik dhe tregëtar, përmbytjen e tokave bujqësore, si dhe ndërprerjen e shkollave për fëmijët, pasi mundësia e komunikimit me rrugë dytësore është e pamundur, për shkak se ato nuk janë në gjëndje të mirë teknike.

Nga monitorimi i situatës në terren, deklaratimet e specialistëve dhe banorëve të këtyre zonave, rezulton gjithashtu se, shkatërrimi i urave ka ardhur për shkak të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga rreshjet e mëdha të shiut në periudhën 15-19 Janar 2016, rritjen e prurjeve të ujit në lumin Shkumbin dhe daljen nga shtrati përtej kufijëve ekzistues të tij. Pa neglizhuar në këtë çështje dhe faktin se, cilësia e punimeve në vepra të tilla siç janë urat, të cilat janë e vetmja mundësi komunikimi për njerëzit dhe mjetet e transportit, kërkojnë cilësi të lartë të punimeve dhe siguri të qëndrueshme për jetën e njerëzve.

Referuar legjisllacionit në fushën e parandalimit dhe planëzimit e masave për përballimin e emergjencave civile, vecojmë ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", VKM nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", si dhe VKM nr.965, datë 02.12.2015 "Për bashkëpunimin institucional të strukturave të drejtimit, në rastet e emrgjencave civile dhe krizave".

Në këtë kuadër, organeve të qeverisjes vendore dhe strukturat përgjegjëse të Emergjencave Civile në Prefekturën e Qarkut Elbasan, konsiderojnë imediate në situatën aktuale, ndërtimin sa më parë të urave të reja, si jetike për jetën e banorëve të kësaj zone. Por pavarësisht shkallës të dëmtimit të urave, ekspertët përgjegjës të kësaj fushe vlerësojnë se, nuk kemi të bëjmë me rastin e shpalljes të emergjencave civile për këto zona, por të një situatë të përkeqësuar për shkak të një fatkeqësie natyrore.

Në kuptim të ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", neni 2/3, përkufizohen termat dhe kuptimet, konkretisht: *"Fatkeqësi natyrore" kuptohen....përmbytjet.....rreshqitjet arkitektonike.....pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore".*

Në vijim të kërkesave të ligjit të lartpërmendur, neni 3 parashikohet se, organet shtetërore *"...janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia..."* që nënkupton marrjen e

masave të menjëhershme dhe veprimeve për riaftësimin dhe kthimin në gjendjen e mëparshme të rajonit (territorit) të prekur nga fatkeqësia.

Njëkohësisht, në bazë të kërkesave të parashikuara në VKM nr.329, datë 16.05.2012, organet e qeverisjes vendore në bashkitë e Elbasanit dhe Peqinit, nisur nga natyra e fatkeqësisë, nevoja për vlerësim dhe karakteri i dëmeve, duhet që në mënyrë të menjëhershme përmes grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim, të kryejnë evidentimin e dëmeve, vlerësimin financiar të objekteve me karakter social dhe publik, siç janë Urat dhe sëbashku me planimetritë dhe preventivat përkatës të dërgohen në drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, në Ministrinë e Punëve të Brëndshme, e cila përgatit projektvendimin për miratim në Këshillin e Ministrave, për përcaktimin e ndihmës financiare nga buxheti i Shtetit, nga mundësitë financiare të organeve të qeverisjes vendore, ose nga burime të tjera.

Gjithashtu në dispozitat e parashikuara në VKM nr.965, datë 02.12.2015, përcaktohet ngritja e strukturave të drejtimit dhe menaxhimit të emergjencave civile dhe të krizave në nivel qendror, rajonal dhe vendor, si dhe nevoja e bashkëpunimit institucional në këto raste.

Konkretisht, strukturat përgjegjëse në nivel rajonal dhe vendor, sipas kreun III, pika 2.3 dhe 2.4, parashikohet të jenë: *“Në përbërje të strukturës së administratës së Prefektit ngrihet sektori i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe krizave”*, si dhe *“Në përbërje të organikës së bashkive planifikohen struktura të përhershme të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile dhe krizave, si më poshtë vijon:*

- *për bashkitë qendër qarku, ngrihet strukturë në nivel drejtorie;*
- *për bashkitë e tjera, ngrihet strukturë në nivel sektori”.*

Parashikimi i ngritjes të strukturave përgjegjëse në nivel rajonal dhe vendor, sidomos në kushtet aktuale kur ato nuk janë ngritur ende, nuk nënkupton se organet e qeverisjes vendore janë dhe përgjegjëse për sigurimin e fondeve për ndërtimin e Urave të lartëpërmendura, për shkak se, ligji nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, neni 8, pika 2/I thuhet specifikisht se: *“Ministria.....është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.....dhe kryen këto detyra:*

- *Bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse”*

Po ashtu, duke qënë se ndërtimi i urave është jetike për banorët e fshatit Broshkë dhe Grykësh, përdorimi i fondeve me procedurë të shpejtuar, parashikohet në VKM nr.329, datë 16.05.2012, Pika 3/h ku thuhet se: *“Fondet e akorduara nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Brëndshme në rastet kur përdoren për riaftësimin e infrastrukturës kritike në territorin e njërive të qeverisjes vendore, si: ura, prita malore, rrugë, diga, argjinatura.....etj., me arsye të motivuara përjashtohen nga procedurat normale të prokurimit, referuar nenit 5/2/c, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar”.*

Sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkëlqe të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe

në nenin 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit... paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,*

REKOMANDOJMË:

“Marrjen menjëherë të masave për ndërtimin e urave të Broshkës (Papër) dhe Grykësh (Pajovë), të shkatërruara nga përmbytjet në muajin Janar 2016, për shkak të daljes nga shtrati të Lumit Shkumbin”.

Për masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ(SALIU)